

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË- Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni civil**, me Kryetaren e kolegjit - gjyqtaren Afijete Sada- Gllongjani dhe Xhavit Elezi e Ismet Këndusi anëtar, duke vendosur në çështjen juridike të paditësit U. M. H. nga B., Gjakovë, përfaqësuar nga i autorizuari D.H. nga B., Gjakovë, kundër të paditurës M. K. H. nga B., Gjakovë, për ndryshim të aktgjykimit, përkitazi me besimin e fëmiut, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 09 nëntor 2016, në prani të autorizuarit të paditësit dhe të paditurës murr këtë;

## **A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** kërkesë-padia e paditësit U. M. H. nga B., Gjakovë, kundër te paditurës M. K. H. nga B., Gjakovë dhe **NDRYSHOHET** aktgjykimi C.nr. 79/2001 datë 14 mars 2001 i Gjykatës së Qarkut në Pejë, përkitazi me besimin e fëmiut, ashtu që e mitura S. H. e lindur në Gjakovë me datë ... vajza e ndërgjyqësve i besohet në ruajtje, mbajtje dhe edukim paditësit U. H. nga B., Gjakovë.

**II.** Caktohen kontaktet e të miturës S. H. me të ëmën M. K. H. dy herë në vit nga 10 ditë gjatë pushimeve dimërore dhe verore, festave Fetare Pashkëve dhe për Krishtlindje atëherë kur e mitura do të jetë në Kosovë së bashku me paditësin dhe atë përmes Qendrës për Punë Sociale në Gjakovë, duke paralajmëruar paditësi ardhjen tek punëtorët e Qendrës për Punë Sociale.

**III.** Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

## **A r s y e t i m**

Paditësi me padi dhe gjatë shqyrtimit e nëpërmjet të autorizuarit të tij ka parashtruar se me aktgjykimin C.nr.79/2001 të datës 14 mars 2001 të Gjykatës së Qarkut në Pejë, është zgjidhur martesë në mes palëve ndërgjyqëse me ç rast është vendosur edhe për besimin e fëmijëve të mitur K., D., V. dhe S. H., të cilët fëmijë me marrëveshje të ish bashkëshortit i janë besuar në mbajtje nënës së tyre M. H., këtu të paditurës. Në momentin e vendosjes lidhur me mbajtjen e fëmijëve, të mitur kanë qenë të gjithë fëmijët e lartë cekur. Me qenë se qëllimi i besimit të fëmijëve të mitur tek nëna ka qenë të kenë mundësinë e rritjes dhe zhvillimit më të mirë të tyre, mirëpo që nga ajo kohë konsiston të jetë periudhë e gjatë kohore, gjatë të cilës ka ardhur edhe deri tek ndryshimi i rrethanave për besimin e fëmijëve të lartë cekur, përkatësisht për vajzën – të miturën S. H. e lindur me ..., e cila është i vetmi fëmijë i mitur tani, ashtu që nga dita e zgjidhjes së martesës e paditura, përkatësisht nëna së bashku me të miturën jeton në Kosovë.

Duke marr parasysh se e paditura nuk ka mundësi të mira materiale e financiare për bartjen e të miturës, për shkak se është e pa punë dhe nuk mund të siguroj mjete për ekzistencën, njëkohësisht edhe duke pasur parasysh diferencën në moshë në mes të miturës S. dhe fëmijëve tjerë tash të rritur prej afro 10 viteve dhe se mundësia e përshtatjes dhe lidhjes së të miturës me fëmijët tjerë, ashtu që për edukimin dhe rritjen e mëtejshme të miturës ekziston bindja se e njëjta domosdoshmëri duhet ti kalohet në besim të paditësit, për faktin se i njëjti edhe gëzon kushte materiale të mira dhe po ashtu jeton në botën e jashtme, është i punësuar dhe mund të siguroj të miturës mirëqenie më të sigurt. E mitura shfaq dëshirë të jashtë zakonshme dhe lidhje shumë të afërt emocionale me paditësin, ashtu që shihet vullneti dhe dëshira e saj për të qenë dhe jetuar afër paditësit.

I autorizuari paditësit sa i përket caktimit të kontakteve personave të miturës me të ëmën ka propozuar që ato të jenë dy herë në vit nga 10 ditë gjatë pushimeve dimërore dhe verore, gjatë festave fetare Pashkëve dhe Krishtlindjeve, atëherë kur e mitura do të jetë në Kosovë së bashku me paditësin dhe atë për mes Qendrës për Punë Sociale në Gjakovë. Kërkesë për ushqimi nuk ka parashtruar sepse e paditura nuk është e punësuar. Për shkak të ndryshimit të rrethanave jetësore ka propozuar që kërkesëpadia të aprovohet si e bazuar.

Shpenzimet procedurale nuk i kërkoi.

E paditura me përgjigje në padi dhe gjatë shqyrtimit ka parashtruar se me paditësin me rastin e zgjidhjes së kurorës ishin pajtuar që fëmijët e tyre të mitur të i besohen nënës, duke marr parasysh rrethanat e që në atë kohë ishin në favorin e fëmijëve ashtu që edhe me dakordimin e të dy prindërve është vendosur në atë mënyrë.

Me kalimin e kohës, kanë ndryshuar rrethanat dhe vajza e vogël S. ka filluar të krijoj raport tjetër me këtu paditësin, ashtu që sa herë që prindi vjen për pushime dhe festa, vajza duket me e lidhur emocionalisht dhe ndihet më mirë afër tij. Ashtu që edhe ajo si nënë e ka vërejtura se vajza ndihet më rehat shpirtërisht afër babait, ka konsideruar se vajza ka jetuar një kohë të gjatë me te, se është shumë më e dhënë kah i ai, sepse mendjen çdo herë e ka tek ai, mendon se është në interesin e saj dhe do të ketë efekt pozitiv në mirë rritjen e saj, po qe se vajza do të jetë përkrah babait. Tani është në moshë më të rritur. Është pajtuar me caktimin e kontakteve të miturës me te siç ka propozuar pala paditëse.

Shpenzime procedurale nuk kërkoi.

Për të vendosur në këtë çështje juridike gjykata bëri nxjerrjen e provave; si ekstraktit të lindjes numër E 1039645 të datës 10 nëntor 2015, Raportit të Qendrës për Punë Sociale në Gjakovë numër 966/16 datë 22 korrik 2016 rrethanave jo kontestuese, ku pas vlerësimit e veç veç e tyre dhe lidhshmërinë e tyre reciproke, në mbështetje të nenit 8 të LPK-se, gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditësit është bazuar dhe u aprovua.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë C.nr. 79/2001 të datës 14 nëntor 2001, i plotfuqishëm me datë 14 mars 2001 është shkukurëzuar martesë në mes të këtu ndërgjyqësve e lidhur me datë 30 dhjetor 1987 pranë Zyrës së Gjendjes Civile-Gërgoc Gjakovë. Fëmijët e përbashkët të mitur të ndërgjyqësve D. H., K. H., V. H. dhe S. H. i janë besuar në ruajtje, edukim dhe mbajtje të ëmës.

Nga ekstrakti i lindjes vërtetohet se e mitura S. H. ka lindur me ... në Gjakovë.

Qendra për Punë Social në Gjakovë, Organi i Kujdestarisë me raportin numër 966/16 të datës 22 korrik 2016 përkitazi me ndryshimin e besimit të miturës S. ka dhënë mendimin që tani e tutje të i besohen në ruajtje, mbajtje dhe edukim babit. Kanë kontaktuar me të dy prindërit e të miturës dhe pas marrjes së deklaratave lidhur me rastin na kanë njoftuar se pasi ka ardhur deri te ndryshimi i rrethanave jetësore janë të mendimit të ndryshohet besimi i të miturës S. H., ashtu që edukimi dhe rritja e më tejshme të i kalohet në besim prindit tjetër përkatësisht babait këtu paditësit, për faktin se i njëjti gëzon kushte që të miturës të i s'uroje mirëqenie më të sigurt.

Gjykata vendosi që të ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë C.nr. 79/2001 sa i përket besimit të miturës S., bazuar në rrethanat jo kontestuese në mes të ndërgjyqësve, mendimit të

dhënë të Qendrës për Punë Sociale dhe duke marr parasysh rrethanat e ndryshuara, moshën më të rritur të miturës dhe kujdesin prindëror që do të ketë paditësi ndaj saj bazuar në nenin 140. (4) të Ligjit për familjen të Kosovës ndryshoj vendimin mbi kujdestarinë duke konsideruar se e mitura do të ketë një jetë më solide, të sigurt, një edukim të drejtë, që do të ndikoj në mirëqenien e saj.

Kontaktet e të miturës me të ëmën e cila nuk e ka nën përkujdesje të miturën caktohen kontaktet sipas nenit 145 të Ligjit për familjen të Kosovës ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u murr bazuar në mos kërkesën e shpenzimeve nga pala paditëse sipas nenit 463 të LPK-së.

Nga të më lartë cekurat u vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**

**C nr. 75/16, datë 09 nëntor 2016**

**Kryetarja e kolegjit-gjyqtarja,  
Afijete Sada-Gllogjani**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar Ankesa në afatin prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj Gjykate.